

MENDIM PAKICE

1. Unë, komisioner Lulzim Hamitaj, si anëtar i trupit gjykues nuk pajtohem me vendimin e marrë nga kolegët e shumicës për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për shkak se subjekti i rivlerësimit, sipas mendimit të pakicës, arriti një nivel të besueshëm edhe në rivlerësimin e pasurisë. Ky qëndrim bazohet në faktet e konstatuara, në jurisprudencën dhe vlerësimet që përshkruhen në vijim.
2. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni ka rezultuar se në DIPP-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar lidhjen e një kontrate paraprake shitblerjeje, si dhe pagesën e këstit të parë për blerjen e një apartamenti në vlerën 73.687 euro, të ndodhur në ***, Tiranë. Si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar kursimet e 22 viteve punë, si dhe një kredi bankare në shumën 5.000.000 lekë – ende e padisbursuar.
3. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar kryerjen e pagesës për blerjen e apartamentit, prej 53.687 euro. Në këtë deklaratë citohet se shuma prej 5.000.000 lekësh buronte nga një kredi bankare. Ndërsa, lidhur me diferencën prej 2.117.300 lekësh, të cilën e ka transferuar në llogarinë e shoqërisë shitëse, në datën 25.2.2011, subjekti ka shpjeguar se për krijimin e saj ishin përdorur kursimet e disponuara *cash* në banesë. Po ashtu, ka rezultuar se në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, në datën 21.3.2016, subjekti ka parashtruar se gjatë vitit 2011 ajo ka pakësuar kursimet e saj *cash* me shumën 2.117.300 lekë, për pagesën e këstit të dytë të apartamentit në analizë, ndërkohë që në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se apartamentin në analizë e ka blerë me kursimet ndër vite nga paga dhe një pjesë të kredisë prej 5.000.000 lekësh të marrë në BKT.
4. Gjithashtu, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar për herë të parë kurtime nga të ardhurat nga puna 20-vjeçare, në formën *cash*, në DIPP-në e vitit 2003, në masën 4.000.000 lekë. Këtë shumë subjekti e ka disponuar *cash*, pjesërisht në BKT, dhe një pjesë ia ka lënë në përdorim vëllezërve të saj për ushtrimin e aktivitetit kambizëm. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar se për krijimin e kurtimeve të disponuara *cash* në banesë, në vitin 2003, e të përdorura më tej për pagesat e kësteve të blerjes së apartamentit në Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën -1.109.056 lekë. Në vitin 2005, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në vlerën 200.000 lekë; në vitin 2006, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë 500.000 lekë; në vitin 2008, subjekti ka deklaruar *cash* në banesë 500.000 lekë nga shitja e automjetit dhe 400.000 lekë *cash* nga paga; në vitin 2009, subjekti ka deklaruar *cash* në banesë 450.000 lekë; në vitin 2010, subjekti ka deklaruar *cash* në banesë 600.000 lekë dhe *cash* në banesë nga mbyllja e depozitave në vlerën 350.000 lekë; në vitin 2011, subjekti ka deklaruar *cash* në banesë në vlerën 600.000 lekë.
5. Duke kryer një përlllogaritje, bazuar në deklaratimet e subjektit mbi kurtimeve të disponuara *cash* në banesë në fund të vitit 2010, gjendja e kurtimeve *cash* të disponueshme do të rezultonte në vlerën 4.000.000 lekë, pra më se e mjaftueshme për të përballuar kryerjen e pagesës së këstit prej 2.117.300 lekësh, për blerjen e apartamentit në fjalë (edhe nëse do të zbritesh shumën prej 1.1 milion lekësh që ka rezultuar pa mbulesë financiare mes kurtimeve *cash* të deklaruara në vitin 2003 – si më sipër).
6. Gjithashtu, në shpjegimet e dhëna nga subjekti – në përgjigje të pyetësorit nr. 2, si dhe në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në mars të vitit 2016 – ajo ka sqaruar se për depozitim të shumës 3.000.000 lekë në vitin 2012 është përdorur nga kurtimeve të disponuara *cash* në banesë nga vitet e mëparshme shuma prej 2.642.700 lekësh, si dhe një pjesë e kurtimeve të vitit 2012.
7. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se në vitin 2014 ka tërhequr nga depozita dhe ka mbajtur në banesë në formën *cash* shumën prej 3.000.000 lekësh dhe e ka përdorur në vitin 2016 për investimin në obligacione në vlerën 2.000.000 lekë.

8. Në përfundim të hetimit dhe pas analizimit të prapësimeve të subjektit, shumatorja e balancave negative për subjektin e rivlerësimit, znj. Merita Selimi, ka rezultuar të jetë në vlerën - 3.117.731 lekë. Në përlllogaritjen e këtij rezultati shumica ka vlerësuar të mos marrë në konsideratë pretendimet e subjektit lidhur me përdorimin e kursimeve të disponuara *cash* në banesë nga vitet e mëparshme dhe të deklaruara si të tilla – pasi nuk ishte deklaruar pakësimi i shumave *cash* në vitet përkatëse të përdorimit.
9. Në cilësinë e anëtarit në pakicë kam pasur një mendim të ndryshëm nga shumica, për sa i përket vlerësimit të disponibilitetit financiar të znj. Merita Selimi dhe të familjes së saj, si dhe peshën që duhet të kenë pasaktësitë në deklaratimet e saj ndër vite lidhur me mosdeklarimin e pakësimit të shumave *cash* të përdorura. Vlerësoj se ky mosdeklarim mbetet në nivelin e një pasaktësie dhe nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm penalizimi, kjo duke mbajtur në konsideratë faktin se (as nga shumica) nuk janë ngritur dyshime mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të gjendjeve *cash* të përdorura për këtë pasuri, si dhe faktin se subjekti i ka vetëkorrigjuar deklaratimet e saj në ILDKPKI, përpara sesa të niste procesin e rivlerësimit.
10. Në këto kushte, për sa kohë pesha më e madhe e kësaj balance negative, në vlerën 2.008.676 lekë, rezulton të jetë krijuar si pasojë e pasaktësisë në mënyrën e deklaratimit të subjektit të shtesave dhe pakësimeve të gjendjes së disponuar *cash* prej saj, si dhe duke u bazuar te jurisprudenca e konsoliduar e Kolegjit¹ vlerësoj se sa më lart nuk mund të përbëjë shkak shkarkimi.
11. Nisur nga e njëjta mënyrë arsyetimi, si më sipër, edhe lidhur me pretendimin e subjektit sipas të cilit ajo ka përdorur shumën prej 2.482.700 lekësh, të disponuar në banesë dhe të deklaruar si gjendje *cash* (ndryshe nga shumica e trupit gjykues), vlerësoj se në kryerjen e analizës financiare të burimeve të ligjshme për krijimin e depozitës në vlerën 3.000.000 lekë, në datën 21.3.2012, duhet të ishte përfshirë edhe kjo shumë (2.482.700 lekë), për sa kohë ishte e disponuar dhe e deklaruar si *cash* në banesë dhe e provuar se ishte krijuar me burime të ligjshme. Nëse kjo shumë do të konsiderohej si burim për këtë pasuri, subjekti do të rezultonte me një pamundësi financiare prej vetëm 470.068 lekë – siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim.

Të ardhura nga pagat 1.1.2012 – 21.3.2012	153,000
Shpenzime të familjes 1.1.2012 – 21.3.2012	(105,768)
Kursime të mbetura <i>cash</i> nga viti 2011	2,482,700
Investuar në depozitë me afat	(3,000,000)
Rezultati në datën 21.3.2012	(470,068)

12. Për rrjedhojë, vlerësoj se edhe nëse do të mbahej e pandryshuar balanca negative e vitit 2003, në vlerën 1.109.056 lekë, duke i shtuar edhe pamundësinë financiare të vitit 2012, në vlerën - 470.068 lekë, do të gjendeshim përballë një bilanci të përgjithshëm negativ për këtë subjekt në vlerën - 1.579.124 lekë. Kjo pamjaftueshmëri financiare, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, nuk do të mjaftonte për masën e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi.
13. Gjithashtu, nuk bie dakord me shumicën lidhur me aplikimin, në rastin konkret, të pikës 5 të nenit 61 të Ligjit nr. 84/2016, pasi nga njëra anë e vlerësoj si një ndëshkim jo proporcional me faktet e përshkruara nga shumica si elemente mbështetëse dhe nga ana tjetër, sipas meje, ky qëndrim bie ndesh me jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke passjellë një penalizim të dyfishtë të subjektit - nëpërmjet aplikimit njëkohësisht të pikës 3 dhe 5 të kësaj dispozite, mbi këto fakte. Konkretisht, - edhe nëse do të merreshin si të mirëqena pamundësitë financiare dhe problematikat që lidhen me deklaratimet apo me shpjegimet (jo mjaftueshëm të qarta/plota), me peshën respektive që u ka veshur shumica, - vlen të theksohet se këto rrethana, për sa kohë ato lidhen ngushtësisht me

¹Shihni vendimin nr. 20/2020 (JR), datë 8.9.2020, paragrafi 19.4 etj., të Kolegjit.

deklarimin e pasurive dhe të burimeve financiare përkatëse, që kristalizohen në parregullsi deklaruese apo mungesë ligjshmërie të burimeve, të cilat në çmimin tim, e kanë ezauruar efektin e tyre “ndëshkues” për subjektin, prej momentit që për këtë të fundit, nga shumica, është aplikuar pika 3 e të njëjtës dispozitë ligjore, (neni 61 i ligjit nr. 84/2016), të lartpërmendur. Kësisoj, vlerësoj se në këtë rast, duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e KPA-së si dhe tipologjinë e të gjitha problematikave që lidhen me kriterin e pasurisë, këto të fundit edhe nëse do të mbartënin një peshë me efekte penalizuese do të mund të kondensoheshin (mjaftueshëm) në aplikimin e (vetëm) pikës 3 të nenit 61 në fjalë dhe jo edhe të pikës 5, për sa kohë, në çmimin tim, mungojnë shkaqet e cenimit të besimit të publikut nga ky subjekt rivlerësimi.

14. Po ashtu, vlerësoj se pasaktësitë lidhur me procedurat e marrjes së një kredie apo të deklarimeve vjetore nuk mund të përbëjnë në vetvete shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masës së shkarkimit, për më tepër kur këto të fundit janë korrigjuar/saktësuar në kohë nga subjekti, pranë organit kompetent (ILDKPKI) dhe përpara paraqitjes së deklaratës për efekt të rivlerësimit kalimtar.
15. Bazuar në sa më sipër, mendoj se subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, do të duhej të ishte konfirmuar në detyrë.

Relator kundër
Lulzim Hamitaj